

1 E enjte, 17 dhjetor 2020

2 [Konferencë për Ecurinë e Çështjes]

3 [Seancë e hapur]

4 [Të akuzuarit paraqiten përmes videolidhjes]

5 --- Fillon në orën 11.00

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirëmëngjes dhe mirëserdhët të
7 gjithë brenda dhe jashtë sallës së gjyqit.

8 Znj. Sekretare, ju lutem të paraqisni lëndën.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes. Lënda KSC-BC-
10 2020-06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri
11 Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit znj. Sekretare.

13 Tani do t'u kërkoj palëve dhe pjesëmarrësve që të
14 prezantohen. Do të filloj me Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

15 Znj. Prokurore, apo z. Prokuror.

16 Z. HARBACH: [Përkthim] Mirëmëngjes, i nderuar Gjykatës. Për
17 Prokurorinë të pranishëm sot janë z. Jack Smith, Prokuror i
18 Specializuar; menjëherë pas meje është z. Sebastian van Hooydonk,
19 që është drejtues i çështjes; në të djathtë kam znj. Clare Lawson;
20 pastaj i pranishëm është z. Alan Tieger; dhe unë jam David
21 Harbach, prokuror në Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.

23 Tani do t'ia jap fjalën Mbrojtjes. Sikurse edhe në
24 Konferencën e mëparshme për Ecurinë e Çështjes, do të ftoj
25 avokatin kryesor të çdo ekipi të Mbrojtjes sipas radhitjes në

1 emrin e lëndës. Do të filloj pra, me z. Thaçi, pastaj me avokatin
2 e z. Veseli, më pas të z. Selimi, dhe pastaj me atë të z.
3 Krasniqi.

4 Do të filloj me z. Hooper. Urdhëroni.

5 Z. Hooper, më duket që nuk e keni ndezur mikrofonin.

6 Z. HOOPER: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Mirëmëngjes, i
7 nderuar Gjykatës. Mirëmëngjes z. Thaçi.

8 Përfaqësoj z. Thaçi sot së bashku me z. Pallaska. Ju
9 faleminderit.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Hooper.

11 Urdhëroni z. Emmerson.

12 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Mirëmëngjes, i
13 nderuar Gjykatës.

14 Unë jam Ben Emmerson në emër të z. Kadri Veseli për seancën e
15 sotme.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

17 Z. Young.

18 Z. YOUNG: [Përkthim] Mirëmëngjes z. Gjykatës. Unë jam David
19 Young, përfaqësues i z. Selimi dhe sot më ndihmon z. Geoffery
20 Roberts.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

22 Znj. Alagendra.

23 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Mirëmëngjes.

24 Unë jam Alagendra për z. Krasniqi.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit.

1 Për procesverbalin, z. Thaçi, z. Veseli, z. Selimi dhe z.
2 Krasniqi nuk janë fizikisht të pranishëm në sallën e gjyqit dhe e
3 ndjekin këtë seancë me anë të videolidhjes.

4 Tani i drejtohem Zyrës Administrative.

5 Z. ROCHE: [Përkthim] Ralph Roche, shef i Njesisë Gjyqësore.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Dhe për procesverbalin, unë jam
7 Nicolas Guillou, Gjykatës i Procedurës Paraprake në këtë çështje.

8 Përpara se të vazhdojmë me rendin e ditës për sot, i kujtoj
9 palët se nëse duan të marrin fjalën për të ngritur një çështje
10 konkrete apo të përgjigjen në ndonjë çështje të ngritur, duhet të
11 çohen në këmbë në qoftë se janë në sallë të gjyqit, apo të çojnë
12 dorën në qoftë se e ndjekin seancën me anë të videolidhjes.

13 Dhe së fundi, ata që janë të pranishëm në seancë përmes
14 videokonferencës, në qoftë se hasin probleme teknike, atëherë
15 duhet të na informojnë menjëherë duke ngritur dorën.

16 Në qoftë se lidhja me pjesëmarrësit nga distanca ndërpritet,
17 atëherë do të bëjmë çmos që ta rregullojmë problemin teknik. Në
18 qoftë se ai nuk zgjidhet menjëherë, atëherë ndoshta do të duhet të
19 kalojmë -- të bëjmë një pauzë të shkurtër derisa të rregullohet
20 problemi teknik.

21 Tani do të kaloj në historikun procedural të çështjes. Më 8
22 dhjetor 2020, unë caktova datën e kësaj Konference të dytë për
23 Ecurinë e Çështjes. Kërkova nga palët që të paraqesin parashtrimet
24 e tyre me shkrim në lidhje me këto tema: nxjerrjen e materialeve;
25 statusin e hetimeve të Prokurorinë; statusin e hetimeve të

1 Mbrojtjes; datën për Konferencën e tretë të Ecurisë së Çështjes;
2 dhe çfarëdo pike tjetër që palët dëshirojnë të ngrenë.

3 Prokuroria nuk bëri parashtrime. Dy ekipe të Mbrojtjes
4 dorëzuan parashtrimet e tyre të martën më 15 dhjetor. Falënderoj
5 z. Hooper dhe z. Emmerson për parashtrimet e tyre me shkrim.

6 Përpara se të kalojmë te rendi i ditës për sot, dua të
7 theksoj se mbrëmë nxora një vendim mbi disa çështje procedurale
8 lidhur me rishikimin e masës së paraburgimit dhe afatet për
9 dorëzimin e mocioneve paraprake.

10 Qëllimi i seancës së sotme është që të rishikohet ecuria e
11 kësaj çështjeje dhe të organizohen shkëmbime midis palëve për të
12 siguruar kryerjen e shpejtë të përgatitjeve për gjykim.

13 Veçanërisht dua të diskutojmë, së pari, nxjerrjen e materialit
14 provues, përkatësisht, nëse palët kanë hasur vështirësi, dhe në
15 qoftë se kanë arritur marrëveshje mes njëra-tjetrën për nivelin e
16 kategorizimit të materialit të nxjerrë, në bazë të rregullës
17 109(c) të Rregullores, dhe për afatet e dorëzimit të tabelave në
18 lidhje me këto materiale.

19 Së dyti, në qoftë se Prokuroria mund të na japë një datë të
20 përafërt se kur mendon se do t'i përfundojë hetimet në kryerje e
21 sipër dhe kur mendon që mund ta dorëzojë dosjen paragjyqësore dhe
22 materialet shoqëruese, duke mbajtur parasysh afatet e parashtruara
23 në Vendimin tim Kornizë lidhur me nxjerrjen e materialeve.

24 Së treti, në qoftë se Mbrojtja mund të na japë informacion
25 lidhur me ecurinë e hetimeve të saj, nëse ka ndërmend të bëjë

1 kërkesë lidhur me mundësinë hetimore unike, apo nëse ka ndërmend
2 të bëjë njoftim për alibi apo për arsye të tjera që përjashtojnë
3 përgjegjësi penale.

4 Së katërti, data për Konferencën e tretë të Ecurisë së
5 Çështjes. Dhe në fund çështje të tjera që mund të ngrenë palët.

6 Do t'u kërkoj palëve të paraqesin vështirimet e tyre në mënyrë
7 të përmbledhur lidhur me secilën pikë. Gjithashtu rikujtoj palët
8 se në qoftë se gjatë parashtrimeve të tyre mund t'i referohen
9 ndonjë informacioni konfidencial, atëherë të ma bëjnë këtë me dije
10 në mënyrë që të kalojmë në seancë të mbyllur ose private.

11 Tani ftoj palët që të ndjekin rendin e ditës të caktuar për
12 këtë Konferencë të Ecurisë së Çështjes.

13 Së pari dua të dëgjoj nga Prokuroria për pikën që lidhet me
14 nxjerrjen e materialit provues dhe për tabelat, në bazë të
15 rregullës 109(c).

16 Fjalën e ka Prokuroria. Znj. Lawson, urdhëroni.

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Në lidhje me procesin e nxjerrjes së
18 materialeve, Prokuroria deri më tani i ka dorëzuar Mbrojtjes 1.309
19 materiale potencialisht shfajësuese, në bazë të rregullës 103.
20 Përveç kësaj, kemi bërë nxjerrjen e materialeve mbështetëse të
21 aktakuzës, në bazë të rregullës 102//siç u përkthye// si në gjuhën
22 shqipe ashtu edhe anglishte. Dhe kemi nxjerrë gjithashtu
23 deklaratat që kemi marrë nga të akuzuarit, në bazë të rregullës
24 102(1)//siç u përkthye//, gjithashtu në gjuhën shqipe dhe në
25 anglishte.

1 Materialet e nxjerra në bazë të rregullës 102(1)//siç u
2 përkthye//, përfshijnë 1.764 dokumente. Duke marrë parasysh
3 problemet teknike që lidhen me nxjerrjen e materialeve, ne po
4 kryejmë një kontroll të hollësishëm për të siguruar që këto
5 vështirësi të hiqen.

6 Prokuroria vazhdon të plotësojë afatet e caktuara. Në
7 përputhje me obligimin tonë të nxjerrjes së materialeve të
8 vazhdueshme, presim që paketën e dytë të materialeve potencialisht
9 shfajësuese t'ia dorëzojmë Mbrojtjes menjëherë pas pushimit të
10 Gjykatës.

11 Lidhur me vështirësitë e hasura, ka pasur siç thashë,
12 probleme teknike me sistemin elektronik 'Legal Workflow'. Për
13 shembull, paketa e materialeve potencialisht shfajësuese u dorëzua
14 nga Prokuroria më datën 10 dhjetor, dhe Mbrojtja i ka pas këto
15 materiale në dispozicion që nga ai moment. Mirëpo, për shkak të
16 problemeve teknike marrësve të këtyre dokumenteve nuk u është
17 dërguar një njoftim elektronik. Janë bërë disa përpjekje të
18 pasuksesshme për zgjidhjen e këtij problemi teknik.

19 Gjithashtu Prokuroria ka hasur në probleme teknike në kalimin
20 e këtyre dokumenteve në sistemin 'Legal Workflow'. Këto probleme
21 teknike janë jashtë kontrollit të Prokurorisë dhe kanë të bëjnë me
22 llojin e sistemit të 'Legal Workflow', dhe këto probleme madje
23 janë edhe jashtë mundësive të Zyrës Administrative për t'i
24 zgjidhur.

25 Ne, për momentin, së bashku me Zyrën Administrative po

1 punojmë drejt kontraktimit të ekspertëve të jashtëm për
2 rregullimin e këtyre problemeve teknike.

3 Mbrojtja e Thaçit ka identifikuar edhe dy pika të tjera që
4 lidhen me metadatat, dhe unë do ta shfrytëzoj rastin tani që të
5 flas për këto dy pika.

6 Pika e parë e ngritur prej Mbrojtjes së z. Thaçi ka të bëjë
7 me llojin e materialit, metadatën për llojin e materialit, dhe e
8 dyta është lidhur me burimin e materialit.

9 Për sa i përket llojit të materialit, Prokuroria është
10 përpjekur që të japë një përshkrim domethënës të dokumentit. Për
11 shembull, në qoftë se materiali është fotografi apo videoincizim,
12 atëherë në përshkrim përmendet ky fakt. Në qoftë se është ndonjë
13 dokument në formatin .mp4 apo PDF, edhe ai gjithashtu mund të
14 identifikohet lehtësisht nga materiale të tjera audio apo video.
15 Metadatat mund të kërkohen shumë lehtë lidhur me këto materiale.
16 Koha që do të na duhej për plotësimin e këtyre të dhënave për
17 metadatat do të ishte mjaft e gjatë.

18 Për sa i përket burimit të informacionit apo kronologjisë së
19 mbajtjes në ruajtje të një materiali, përsëri nuk duhet një urdhër
20 i Gjykatës. Fusha që përmban informacionin për burimin e
21 informacionit është qartësisht e shënuar.

22 Mbrojtja e z. Thaçi ka përmendur në parashtimet e veta dy
23 shembuj që lidhen me metadatat për burimin e informacionit. E para
24 është përshkrimi "Intervistë me Dëshmitarin e ZPS-së". Ky
25 përshkrim është përdorur për të indikuar një transkript të një

1 interviste të kryer prej ZPS-së. Shembulli i dytë është -- si
2 shembull i dytë citohet një përshkrim i burimit të informacionit,
3 ku identifikohet si burim i tillë një bibliotekë, dhe përshkrimi
4 që kemi dhënë ne është mjaft i qartë.

5 Nuk ka kurrfarë boshllëqesh në kronologjinë e mbajtjes në
6 ruajtje të materialeve dhe nuk ka ndërmjetësues të fshehur, siç
7 përmenden në parashtimet e Mbrojtjes së z. Thaçi. Në qoftë se ka
8 mbetur ndonjë gjë e paqartë, ne jemi të gatshëm që Mbrojtjes t'i
9 japim shpjegime dhe qartësime të mëtejshme. Për mendimin tonë këto
10 përshkrime të metadatave janë bërë në mënyrë të qartë dhe të
11 plotë.

12 A mund tani të kaloj te materialet e rregullës 109(c), i
13 nderuar Gjykatës?

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Po.

15 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Nga parashtimet e avokatit të z.
16 Thaçi del që nuk është bërë ndonjëfarë përparimi për sa i përket
17 një marrëveshje midis palëve, në bazë të rregullës 109(c). Sikurse
18 theksohet edhe në parashtimet e Mbrojtjes së z. Selimi, nuk është
19 arritur ndonjë ndryshim.

20 Këtu kemi hasur në një ndeshje midis asaj që do të ishte
21 ideale dhe asaj që do të ishte praktike. Prokuroria tashmë ka
22 thënë qartë se çdo peshë apo barrë që do t'i jepej Mbrojtjes apo
23 Prokurorisë në këtë drejtim do të shkaktonte vonesa të panevojshme
24 në afatet e dorëzimit të materialeve. Ne jemi të përkushtuar që të
25 bëjmë atë që është më praktike. Ndarja që është bërë në katër

1 kategoritë, është bërë sipas atyre që identifikohen në rregullën
2 109, dhe ju i nderuar Gjykatës këtë mënyrë të veprimit e keni
3 pranuar në rastin Mustafa.

4 Thënë thjesht, është një zgjedhje midis marrjes së
5 dokumenteve në kohën e duhur apo brenda afatit, apo marrjen e
6 kategorive shtesë për këto dokumente. Ju faleminderit.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit znj. Lawson.

8 Z. Hooper, e keni fjalën. Mikrofonin ju lutem z. Hooper.

9 Z. HOOPER: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Nuk do të
10 çuditeni, i nderuar Gjykatës, që unë nuk po flas vetëm për
11 çështjen e nxjerrjes së materialeve në format e tyre të ndryshme.
12 Kështu që unë do të flas për atë që tha kolegja -- sapo sugjeroi
13 kolegja, dhe do të ketë diskutime të tjera ndërmjet palëve për
14 çështjet që ngriti ajo.

15 Po mbasi e thashë këtë, i nderuar Gjykatës, ju jeni në dijeni
16 për formatin e listës që ka shoqëruar materialet që janë dorëzuar,
17 qoftë në lidhje me materialet shfajësuese apo ato që kanë të bëjnë
18 me pikat 9 deri në 12 për materialet inkriminuese. Dhe kur i
19 shikojmë kolonat që kanë të bëjnë me "Kategoritë", ne siç e kemi
20 thënë dhe në parashtimin me shkrim, këto janë krejtësisht të
21 pamjaftueshme dhe të papërshtatshme. Faktikisht në atë kolonë mund
22 të mos ketë asgjë sepse nuk ka tregues për informacionin që jepet
23 aty për personin që e shikon.

24 Pra, cili është objektivi i pasjes së një kategorie në qoftë
25 se nuk e ndihmon personin që do të shikojë materialin që po

1 dorëzohet? Dhe ky material i dorëzuar nga pala që e ka pasur atë
2 material në dorë për një kohë të gjatë dhe bën përpjekje shumë të
3 vogla për të dhënë përshkrime të gjata për të.

4 Për shembull, kur thotë për krimet si krime bazë, a është e
5 përshtatshme kjo? A është e mjaftueshme? Çfarë krimesh? Me çfarë
6 lidhesh? Me çfarë sjellje të të akuzuarit? Pra, i kthehemi përsëri
7 atij argumentit që janë bërë punë në përgjithësi dhe jo të
8 specifikuara që e kemi ngritur si Mbrojtje që në fillim. Cili i
9 akuzuar? Me çfarë elementesh kontekstualë lidhesh? Pse nuk
10 specifikon se është krim kundër njerëzimit apo krim lufte?

11 Pra, kur thotë kolegja ime që ne po flasim për rregullat dhe
12 për interpretimin statutor të tyre, kjo nënkupton se ne po bëjmë
13 një kërkesë të skajshme apo po kërkojmë shumë hollësi. Megjithatë
14 këto faktikisht janë thjesht konform rregullës 109(c). Pra, unë
15 përsëris paragrafin 13 të parashtimit tonë me shkrim pra, në
16 lidhje me këtë.

17 Në lidhje me nxjerrjen e materialeve, ne jo vetëm na duhet
18 informacion i mëtijshëm për kategoritë por edhe për llojin e
19 materialit që jepet, sepse këto nuk dalin në 'Legal Workflow', në
20 sistemin elektronik. Unë nuk e di se për çfarë mjetesesh ndihmëse të
21 tjera flet kolegja, që thotë do ta mbështesin apo do ta ndihmojnë
22 Mbrojtjen. Kjo është pika e parë e referencës kur jepet materiali,
23 na jepet materiali neve.

24 Për sa i përket origjinës së dokumentit. Mbjajtja në ruajtje e
25 dokumentit, ose kronologjia e mbajtjes në ruajtje të dokumentit na

1 duhet. Duhet të dimë se ku është gjendur dokumenti dhe se kush e
2 ka pasur në dorë atë. Na duhen hollësi të tjera për këtë.

3 Siç e thashë pra, ne diskutimet e tjera me Mbrojtjen -- me
4 Prokurorinë do t'i bëjmë, po nuk e di sesa të frytshme do të jenë.
5 Po megjithatë jemi të gatshëm t'i hymë këtyre diskutimeve.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

7 Z. Emmerson.

8 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] I nderuar
9 Gjykatës, ju e dini që në fillim që ne në emër të z. Veseli,
10 Mbrojtja e z. Veseli ka një pozicion shumë të thjeshtë, që është
11 detyrimi i Prokurorisë që të plotësojë kërkesat e nxjerrjes së
12 materialeve sipas legjislacionit të zbatueshëm.

13 Pra, unë nuk kam marrë pjesë në diskutimet në lidhje me
14 formulimin e tabelës së identifikimit të dokumenteve dhe nuk
15 mendoj që në këtë fazë është praktike që Mbrojtja të bëjë
16 parashtime në lidhje me përshtatshmërinë apo mjaftueshmërinë e
17 materialeve. Ne kemi marrë, siç e dëgjuat, rreth 3.000 dokumente
18 në një kohë shumë të shkurtër, dhe e vetmja përgjigje realiste
19 ndaj kësaj do të ishte sigurisht, secili prej këtyre dokumenteve
20 do të kërkojë analizë metikuloze nga -- dhe shqyrtim metikuloz nga
21 Mbrojtja. Asnjë avokat mbrojtës që është përgjegjës nuk do t'ia
22 kalonte, delegonte një analizë të tillë Prokurorisë.

23 Po kështu, mbasi e kam thënë këtë, mbasi është bërë analiza,
24 kur të bëhet e qartë që ka boshllëqe në nxjerrjen e materialeve
25 apo vazhdimësinë e tyre, ne rezervojmë të drejtën që të bëjmë

1 parashtrime dhe në lidhje me këtë. Në kushte reale, Mbrojtja është
2 vetëm në fillim të procesit të identifikimit të kategorive të
3 materialeve që ka nxjerrë Prokuroria, dhe për këtë arsye nuk mund
4 të bëjë parashtrime të informuara në lidhje me përshtatshmërinë e
5 procedurave që janë kryer.

6 Unë nuk do të bëj këtu kritika të copëzuara në mënyrën sesi -
7 - për mënyrën sesi Prokuroria i ka paraqitur materialet e veta apo
8 analizuar materialet e veta. Kjo është detyrimi i Prokurorisë. Ne
9 po presim të shohim sesi do ta bëjnë ata punën e tyre.

10 Pra, kaq kam për thënë në këtë fazë. Është e parakohshme të
11 flasim për përshtatshmërinë edhe mjaftueshmërinë e materialeve të
12 nxjerra. Këto do të jenë më të gjata dhe më të hollësishme në një
13 fazë më të vonshme.

14 Ju e dini, i nderuar Gjykatës, që Mbrojtja e z. Veseli nuk ka
15 dorëzuar parashtrime në lidhje me redaktimet shumë të mëdha që
16 janë bërë në aktakuzë. Po kështu është e pamundur për ne që të
17 bëjmë parashtrime të informuara për relevancën e këtyre
18 redaktimeve.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Emmerson.

20 Tani z. Young.

21 Z. YOUNG: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, ju i kërkon
22 Mbrojtjes t'ju thotë nëse kanë vështirësi në lidhje me nxjerrjen e
23 materialeve dhe dorëzimin e tyre. Dhe do të them që kemi
24 vështirësi të konsiderueshme në lidhje me qasjen që ka ndërmarë
25 Prokuroria.

1 Ju, i nderuar Gjykatës, mund t'ju kujtohet që në Konferencën
2 e mëparshme për Ecurinë e Çështjes, unë ju fola për rëndësinë që
3 ka nxjerrja e materialeve në mënyrë të kuptimshme dhe të
4 përgjithshme. Duke pas parasysh se e drejta për marrjen e
5 dokumenteve në mënyrë të drejtë dhe të përshtatshme është
6 sinonimike me një gjyq të drejtë dhe gjykim të drejtë, pra, e
7 shikoni sesa rëndësi i japim kësaj.

8 Dhe unë paralajmërova për rrezikun që kjo -- procesi i
9 dorëzimit të materialeve të bjerë në një vrimë të zezë d.m.th.,
10 kompjuterike, dhe kërkova që t'ju theksoj sesa i rëndësishëm është
11 kategorizimi i informacionit.

12 Sepse faktikisht Prokuroria nuk e ka plotësuar këtë detyrim
13 të saj, sepse kategorizimi që ka bërë tani, i pretenduar, nuk
14 është i dobishëm fare. Aty ka disa kategori si "Prova për t'u
15 Paraqitur", "Sjellja e Pretenduar e të Akuzuarit". Të gjitha këto
16 janë pakuptim dhe detyrimet e Prokurorisë sipas rregullës 109 nuk
17 janë plotësuar.

18 Për shembull, nën rregullën 109(a), pala duhet të mund të
19 kërkojë në mënyrë elektronike materialet relevante. Dhe unë bëj
20 pyetjen retorike: Si do të jetë Mbrojtja në gjendje të kërkojë në
21 mënyrë elektronike materialet kur i jepen "Provat që do të
22 Paraqiten"?

23 Në qoftë se shikoni formulimin e rregullës 109(c), palët për
24 masën që është praktike "duhet ta karakterizojnë -- duhet ta
25 kategorizojnë informacionin në përputhje me akuzat në aktakuzë,

1 duke përmendur në mënyrë specifike krimet bazë, elementet
2 kontekstualë të veprave penale, sjelljen e pretenduar ...” edhe
3 kështu me radhë.

4 Në rregullën 109(c), flitet për kategoritë. Qëllimi i
5 rregullës 109 është që të bëhet kategorizimi i informacionit. Ne e
6 dimë se cilat janë kategoritë.

7 Dhe ju e dini që në dorëzimin e -- në parashtimin që kemi
8 bërë më 27 nëntor 2020, ne bëmë parashtime specifike në lidhje me
9 rregullën 109(c), dhe kemi shpjeguar llojin e informacionit që do
10 të përfshihet në dorëzimin e materialeve. Pra, kjo është në faqen
11 2, paragrafi 2, të parashtimit tonë.

12 Pra, dorëzimi i dokumenteve duhet të jetë i organizuar, duhet
13 të jetë i kuptueshëm dhe duhet të ketë referime ndaj akuzave të
14 bëra. Për shembull, koha, lloji i krimit, vendi i krimit, forma e
15 përgjegjësisë penale, dhe këto janë të gjitha informacione bazë.

16 Dhe Prokuroria duhet ta dijë çfarë argumentesh kanë. Ata
17 duhet -- ata kanë bërë hetime për një kohë të gjatë, kanë
18 informacionin relevant dhe ata duket sikur kanë marrë vendimin
19 strategjik që të mos të plotësojnë detyrimet e tyre për nxjerrjen
20 e materialeve. Pra, në qoftë se kjo lejohet, kjo do të paragjykojë
21 dhe do të dëmtojë përgatitjen e Mbrojtjes dhe hetimet tona, dhe do
22 të na shtojë shumë punën tonë në mënyrë të jashtëzakonshme.

23 Kolegia e Prokurorisë u përpoq të thoshte që Mbrojtja duhet
24 të shohë sesi është vendosur në çështjen Mustafa. Siç e kuptoj
25 unë, Mbrojtja në atë rast ka rënë dakord me Prokurorinë.

1 Megjithatë, me gjithë respektin që kam, këto janë çështje krejt të
2 ndryshme. Prandaj, këto janë paraqitjet që bëj unë -- parashtrimet
3 që bëj unë për këtë rast.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Znj. Alagendra.

5 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] A mund t'ia
6 jap fjalën z. Ellis për vështirësitë që kemi pasur ne me nxjerrjen
7 e materialit dhe kategorizimin e tyre.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Ellis.

9 Z. ELLIS: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Ne vlerësojmë
10 mundësinë që na jepet për t'i dhënë informacion Gjykatës në këtë
11 moment. Ne materialet që i kemi marrë më 11 dhe më 15 dhjetor jemi
12 duke i lexuar. Këto janë materiale shumë të -- është një sasi
13 shumë e madhe materialesh dhe nuk kemi pasur mundësi që t'i
14 lexojmë të gjitha. Pra, sot nuk jemi në gjendje të japim ndonjë
15 përditësim më të kuptimshëm në lidhje me to.

16 Në lidhje me rregullën 109(c), realiteti është që ne nuk kemi
17 arritur midis palëve të kemi bërë ndonjë progres të mëtijshëm. Ju,
18 i nderuar Gjykatës, e dëgjuat edhe nga palët e tjera sot, ne
19 mbështesim atë që tha Mbrojtja e z. Selimi dhe parashtrimet me
20 shkrim që bëri Mbrojtja e Thaçit.

21 Kam dy çështje të shkurtra. Ne themi, së pari, që formulimi i
22 rregullës 109(c) është i qartë dhe kërkon nxjerrjen e materialeve
23 -- palën që bën nxjerrjen e materialeve të kategorizojë
24 informacionin në lidhje me akuzat. Dhe duke i vënë atyre një etikë
25 thjesht si "Krime Bazë", nuk bën kategorizimin e informacionit në

1 përputhje me akuzat në aktakuzë. Në një çështje gjyqësore si kjo,
2 ajo që kërkohet është që të bëhet lidhja me akuzën konkrete dhe
3 vendin ku ka ndodhur vepra e pretenduar.

4 Pika e dytë. Për qëllimin e rregullës 109(c), ne duhet të
5 ndihmohemi si palë marrëse e këtyre informacioneve duke bërë
6 kategorizimin e tyre. Dhe duke dhënë, bërë një etiketë të tillë si
7 "Krimet Bazë" që është kaq e gjerë, nuk na ndihmon.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

9 Znj. Lawson, dëshiron të marrësh fjalën për t'ju përgjigjur
10 asaj që u tha nga Mbrojtja?

11 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Ne e kundërshtojmë padyshim
12 karakterizimin e avokatit të z. Selimi, se ne nuk i kemi
13 përmbushur detyrimet tona të bërjes së njohur të materialeve. Unë
14 u vura në dijeni për hapat e ndërmarra dhe për qëndrimin e Zyrës
15 së Prokurorisë për çështjet e ngritura.

16 Lidhje konkrete që kërkohet në lidhje me kategorizimin, do
17 t'ju jepet në formën e një tabele, lidhur me rregullën --
18 materialet që vijnë sipas rregullës 102(b).

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit znj. Lawson.

20 Së pari, mora shënim që diskutimet midis palëve do të
21 vazhdojnë lidhur me temën e parë. Shoh gjithashtu se ka
22 mosmarrëveshje lidhur me palët për interpretimin e rregullës
23 109(c). Ju ftoj që të vazhdoni të punoni për këtë çështje dhe do
24 të shoh nëse ka nevojë për një vendim për këtë çështje në javët e
25 ardhshme.

1 Nëse asnjëra nga palët nuk ka ndonjë gjë për të shtuar për
2 këtë temë. Nuk ka. Atëherë po kalojmë te tema e dytë në programin
3 e sotëm, dhe po i drejtohem Prokurorisë për të pyetur për gjendjen
4 e hetimeve, ecurinë e tyre.

5 A mund të na jepni ndonjë datë se kur mendoni se do t'i
6 përfundoni hetimet e mbetura, dhe kur afërisht mendoni se do të
7 jeni në gjendje të paraqisni dosjen paragjyqësore dhe materialet e
8 ndërlydhura me të?

9 Z. TIEGER: [Përkthim] Faleminderit i nderuar Gjykatës. Do t'i
10 përgjigjem unë kësaj.

11 Lidhur me pyetjen nëse ka një datë të përafërt lidhur me
12 përfundimin e hetimeve, dua të theksoj se përpjekjet tona hetimore
13 do të përcaktohen nga Rregullat e Procedurës dhe Provave, që
14 parashikojnë që pas një faze të procedurave përdorimi i
15 deklaratave të dëshmitarëve, përdorimi i tyre, kërkojnë autorizim
16 apo leje.

17 Kjo siguron që përgatitja e shpejtë për gjyq të mos
18 ndërpritet, kur ndërkohë kjo përputhet edhe me përvojën e
19 tribunaleve të tjerë dhe të Gjykatës Ndërkombëtare Penale, që
20 hetimet mund të vazhdojnë. Dhe ka shumë interesa, shumë arsye në
21 interes të drejtësisë përse hetimet lejohen të vazhdojnë, duke
22 filluar nga paraqitja e dëshmitarëve që kanë pas frikë, të cilët
23 tani gjejnë kurajë të japin informacion, deri te zbulimi i
24 materialeve të rëndësishme që kanë qenë të fshehura apo që lidhen
25 me kredibilitetin e dëshmitarit. Pra, janë çështje të cilat duhen

1 shikuar. Këto janë vetëm disa nga shumë shembuj, të cilët
2 justifikojnë mandatin e vazhdimit të hetimeve.

3 Unë jam në dijeni të shqetësimeve që kanë dalë nga rrethanat
4 kur hetimet e gjata pas aktakuzës janë parë si arsye për vonesën e
5 fillimit të gjyqimit. Kjo në fakt është qartësisht jo kështu në
6 këtë rast. Këtu, në këtë rast, Prokuroria kërkon një datë ku
7 hetime të mëtejshme do të kërkonin lejen gjyqësore dhe në këtë
8 mënyrë do ta kufizonin fushëveprimin e hetimeve të mëtejshme.

9 Shkurt, pse ne nuk jemi në gjendje t'ju japim një datë dhe
10 nuk do të jepnim një datë për fundin e parashikuar të hetimeve,
11 kjo nuk do të ndikojë keq në objektivin tonë për një gjykim të
12 shpeshtë dhe të drejtë, përkundrazi ne mendojmë se do ta shtonte
13 këtë gjë.

14 Nuk e di nëse Gjykata dëshiron që unë të vazhdoj të flas për
15 pjesën e dytë të pyetjes tani?

16 Për sa i takon vlerësimit tonë se kur ne do të jemi në
17 gjendje të parashtrojmë dosjen paragjyqësore dhe parashtimet në
18 bazë të rregullës 95, në këto rrethana, pra, bazuar në
19 parashikimet tona aktuale për fillimin e gjyqit në shtator - të
20 cilën do t'jua shpjegojmë - ne do të ishim të përgatitur të
21 parashtronim dosjen paragjyqësore dhe materialet e ndërlidhura me
22 të në fillim të korrikut. Pra, i bie dy, tre muaj përpara fillimit
23 të gjyqit.

24 Dua të shtoj se kushti që ne e shohim në kuadrin e këtij
25 institucioni si një kuadër holistik të integruar, dhe do t'jua

1 shpjegoj sesi Prokuroria dhe përpjekjet hetimore të Prokurorisë
2 lidhen me ecurinë e gjyqit, këto janë faktorë të cilat nuk duhen
3 shprehur. Në qoftë se data e parashikuar e gjyqit do të
4 ndryshonte, ne do t'i qëndrojmë mendimit tonë pra, që sapo thashë,
5 që do t'i paraqesim dokumentet dy, tre muaj para gjyqit, jo që t'i
6 dërgojmë përpara sesa të fillojë gjyqi.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

8 Tani ia jap fjalën Mbrojtjes për temën e hetimeve të
9 Prokurorisë. Z. Hooper, e keni fjalën.

10 Z. HOOPER: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] E di që kolegu i
11 referoi dy, tre muaj para fillimit të gjyqit. Shpresoj që të mos
12 di diçka që ne nuk e dimë. Nuk kam konstatim tjetër për të bërë në
13 këtë gjë.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Hooper.

15 Z. Emmerson, ju lutem.

16 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] I nderuar
17 Gjykatës, nuk do të kundërshtoja në fakt formulimin bazë të z.
18 Tieger lidhur me nevojën që Prokuroria, dhe në fakt dhe Mbrojtja,
19 të mund të vazhdojnë hetimet në rrethana të caktuara, teksa
20 procesi dhe gjyqi ndjek rrugën e vetë me kusht që të mos dalin
21 çështje të cilat duhen trajtuar në mënyrë të papritur.

22 Ajo që ne sugjerojmë është që ka nevojë të ketë një gijotinë
23 - dhe po e përdor fjalën në mënyrë të përgjithshme - një gijotinë
24 e cila duhet përdorur kur të vijë momenti i duhur, që në fakt
25 është data përtej të cilës, siç tha z. Tieger, miratimi gjyqësor

1 kërkohej pa diskutim dhe prezumimi është që Prokuroria nuk do të
2 kishte të drejtë të paraqiste prova sipas dëshirës. Pra, çështja
3 është, kur duhet të jetë data që të përdoret kjo gijotina.

4 Dhe kjo më sjell te pika e dytë, pikë kur unë ndahem shumë
5 nga z. Tieger dhe nga qëndrimi i Prokurorisë që ka përqafuar në më
6 shumë se një rast. Pra, në qoftë se ka një lidhje të pashkëputshme
7 midis ecurisë së punës së hetimeve të Prokurorisë dhe detyrimit të
8 saj për të bërë të njohur materialet dhe afërsia e datës së
9 gjykimit, dëshiroj që ta analizoj shkurtimisht në qoftë se më
10 lejoni, meqenëse ka dalë në disa raste kjo çështje.

11 Ajo që z. Tieger sapo ju tha është që data kur Prokuroria
12 duhet që ta ngrejë flamurin e saj, të themi, të luftës,
13 figurativisht pra, duhet të jetë e përshtatshme. Duhet të jetë tre
14 muaj përpara afatit -- fillimit të gjykimit.

15 Dhe i vetmi konkluzion që mund të nxirret është që Prokuroria
16 mendon se nuk do të ishte në interesin e saj nëse Mbrojtja do të
17 kishte më shumë se tre muaj për t'u përgatitur për çështjen e saj,
18 pasi Prokuroria ka identifikuar plotësisht parametrat e provës dhe
19 të akuzave në mënyrën sesi ato duan t'i lidhim me njëra-tjetrën.
20 Dhe kjo është një arsye për një shqetësim mjaft të rëndë.

21 Herën e fundit, avokati i Prokurorisë tha që kjo datë duhet
22 të afrohet dhe gjithashtu dosja paragjyqësore duhet të afrohej ose
23 të largohej për një datë realiste të gjykimit. Dhe ne dëgjuam
24 përsëri nga z. Tieger, i cili thotë që mund të jemi gati për të
25 parashtruar dosjen paragjyqësore në qershor apo korrik, por vetëm

1 nëse gjyqi do të fillojë në shtator. Nëse gjyqi nuk fillon, edhe
2 pse ne do të ishim gati në korrik apo qershor, ne duam ta shtyjme,
3 duam ta mbajmë për vete pra. Duam që përgatitjet tona të --
4 përgatitjet tona duhen bërë brenda tre muajsh sipas Prokurorisë.

5 Mendova se unë e vura në dukje që përpara që kjo nuk është e
6 drejtë, dhe habitem që Prokuroria jep këtë përgjigje, që vazhdon
7 të japë të njëjtën përgjigje. Prokurori thotë që nuk duam pra që
8 ta shtyjme, të ndahen të dhëna. Është një, në fakt, parashtim
9 shokues, sepse vetëm një arsye për këtë mund të ketë, që të
10 kufizojë mundësinë e Mbrojtjes për t'u përgatitur duke i vendosur
11 një kufi.

12 Në qoftë se rregullat e ligjit do të thoshin që një gjykim i
13 drejtë kërkon që Mbrojtja të ketë pak kohë për t'u përgatitur, do
14 ta thoshte këtë gjë. Fakti që nuk e thotë është i qartë, sepse kjo
15 përputhet me rregullat themelore të drejtësisë të cilat kërkojnë
16 një kohë të arsyeshme për t'u përgatitur për gjyq. Kjo përcaktohet
17 nga vëllimi, nga kompleksiteti i materialit, dhe jo nga një afat
18 arbitrar që Prokuroria kërkon ta vendosë për t'ia bërë punën më të
19 vështirë Mbrojtjes.

20 Sugjerimi këtu është që gijotina e Prokurorisë, në kuptimin e
21 datës që ajo kërkon për të përcaktuar çështjen e saj, sepse ne e
22 kuptojmë procesin që po kalojnë ata në lidhje me pikën e parë të
23 programit që ju ngritët, nuk është një mjet për t'i dhënë
24 Mbrojtjes informacion të konsiderueshëm dhe nuk zëvendëson faktin
25 që Mbrojtja e vendos vetë se kur është momenti i rëndësishëm. Por

1 ka një moment që Prokuroria duhet të thotë: Dhe ky është rasti që
2 ju i keni përmbushur kërkesat tuaja.

3 Z. Tieger ka thënë shumë qartë që Prokuroria mund ta bëjë në
4 korrik apo në qershor. Pra, dhe ideja që mbas tre muajsh do të
5 jetë gjyqi, kjo nënkupton kohën që Mbrojtja duhet të ketë nga
6 sqarimi i çështjes nga Prokuroria dhe deri në fillimin e gjykimit,
7 pra, tre muaj. Dua ta vendos këtë në një kontekst.

8 Bashkëngjitur kërkesës për lirimin e përkohshëm do të keni
9 një pjesë -- një artikull shumë të rëndësishëm kërkimor të
10 gjykatave, tribunalëve ndërkombëtare pra, dhe Gjykatës
11 Ndërkombëtare Penale lidhur me kohën -- kohëzgjatjen që nga
12 momenti i paraqitjes së parë deri në fillimin e gjykimit. Do të
13 ishte e mjaftueshme t'ju thosha se statistikat tregojnë që TPNJ-ja
14 pra, kohëzgjatja që nga paraqitja e parë deri në fillimin e
15 gjykimit ishte 3,6 vite.

16 Dhe kjo është një periudhë shumë e gjatë. Dhe është
17 absolutisht e drejtë që përpjekjet duhen bërë nga tribunalët
18 ndërkombëtarë për ta paraqitur këtë çështje, dhe Gjykata
19 Ndërkombëtare Penale e ka ulur, e ka çuar në 2,3 vite. Por kjo
20 lidhet me faktin sesa kohë duhen për të bërë një hetim të duhur në
21 çështje të kësaj -- kaq komplekse.

22 Dhe sidomos duke i lënë mesataret mënjanë, sepse kjo varet
23 nga natyra e ndryshme e çështjeve. Ka dy çështje të cilat mund të
24 jenë shumë paralele me këtë që kemi ne: Gjyqi Limaj dhe të tjerët
25 në TPNJ dhe gjyqi Haradinaj po i TPNJ-së. Të dy gjyqet përfshinin

1 pra, ndërmarrjen e përbashkët penale ndaj -- kundër anëtarëve të
2 UÇK-së.

3 Ndryshe nga kjo çështje, kjo nuk mbulonte të gjithë Kosovën.
4 Në këtë rast ishin -- në atë rast ishin tre të akuzuar. Koha ishte
5 e kufizuar. Te Haradinaj ishte gjashtë muaj. Zona gjeografike
6 ishte e kufizuar. Në Haradinaj ishte një fushë, një zonë nga
7 Dukagjini, në zonën operative të Dukagjinit, relativisht një zonë
8 e vogël e Kosovës perëndimore. Në çështjen e Limës, po ashtu një
9 zonë më e përmbledhur.

10 Në të dy çështjet pra, zonat ishin të kufizuara, periudhat
11 kohore shumë më të shkurtra dhe tre nga katër të akuzuar që kemi
12 tani. Dhe koha që konsiderohej e nevojshme për përgatitjen dhe
13 paraqitjen e hetimeve të Mbrojtjes, nga paraqitja e parë deri në
14 fillimin e gjyqit, ishte 18 muaj në rastin e parë dhe dy vjet në
15 rastin Haradinaj.

16 Pra, është e qartë se këto janë minimume bazë që kur në këtë
17 rast ku bëhet fjalë për mbi 100 vrasje, secila prej të cilave
18 duhet hetuar veç e veç nga ana mjekoligjore e të tjera, bashkë me
19 një numër shumë të madh ndalimesh të pretenduara të paligjshme, të
20 gjitha këto duhen hetuar. Pra, nocioni që gjyqi mund të fillojë
21 tre muaj pasi Prokuroria ka dorëzuar dosjen e saj, është qesharak.
22 Në fakt nuk është vetëm qesharak, po është zbulimi i një përpjekje
23 të Prokurorisë për të pasur një gjyq të padrejtë.

24 Sigurisht që është e padiskutueshme që ne nuk do ta lejojmë
25 që të ndodhë. Dhe unë po ju them se nuk është çështje negociatash

1 apo kuvendimesh, është e drejta bazë minimale për të pasur një
2 gjyq të drejtë. Dhe gjyq i drejtë është ai që përmban Kushtetuta,
3 Konventa Evropiane, e cila duhet të -- pra, gjyqi duhet të fillojë
4 mbasi Mbrojtja të ketë bërë përgatitjet e saj.

5 Dhe siç thashë, kjo nuk ka të bëjë me ndonjë marrëveshje apo
6 me kuvendime. Nuk është vlerësim. Është një minimum, është një e
7 drejtë bazë minimale. Duke pasur parasysh përvojën e gjykatave
8 ndërkombëtare, unë them që Prokuroria nuk mund ta ketë me të
9 vërtetë, nuk mund ta ketë seriozisht këtë që thotë.

10 Ne sugjerojmë sot që ta presim këtë lidhje midis detyrës së
11 Prokurorisë për të paraqitur çështje dhe fillimit të gjyqit. Neve
12 ju sugjerojmë që ju ta hidhni poshtë me vendosmëri atë që tha z.
13 Tieger, dhe se me ndërgjegje dhe në interes të drejtësisë duhet që
14 të detyroni -- ta ndani d.m.th., detyrën e Prokurorisë nga fillimi
15 i gjyqit. Dhe pastaj t'i lejoni Mbrojtjes që të përgatitet
16 përkatësisht bazuar në natyrën, gamën dhe nevojën e hetimeve për
17 Mbrojtjen. Lidhur me një datë pra, e vendosni ju.

18 Por që Prokuroria të na lejojë neve kaq pak kohë për t'u
19 përgatitur që të arrijë një -- atë që kërkon pra, një gjyq me një
20 pritë të themi, nuk lejohet. Kaq kisha.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit shumë z. Emmerson.
22 Z. Young, fjala është për ju.

23 Z. YOUNG: [Përkthim] I nderuar z. Gjykatës, jam plotësisht
24 dakord me z. Emmerson. Nuk kam asgjë për të shtuar.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Young.

1 Znj. Alagendra ose z. Ellis.

2 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] I nderuari
3 z. Gjykatës, edhe ne jemi plotësisht dakord me parashtrimet e z.
4 Emmerson.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit znj. Alagendra.

6 Z. Tieger, dëshironi që të përgjigjeni?

7 Z. TIEGER: [Përkthim] Faleminderit shumë z. Gjykatës. Dua
8 vetëm shkurtimisht të them që parashtrimet e z. Emmerson
9 mbështeten në pikëpamjen e tij sa i takon kohëzgjatjes së
10 nevojshme për të filluar procesin gjyqësor. Kjo bazohet në një
11 krahasim me kohëzgjatjen sipas përvojës së TPNJ-së.
12 Ne i kemi parashtruar me shkrim arsyet tona përse ne nuk
13 pajtohemi me këtë pikëpamje, po thjesht këtu dëshiroj që të them
14 që hedh poshtë karakterizimin e qëndrimit tonë në parashtrimet
15 tona të mëparshme sikur ato reflektojnë një tentativë për të
16 minuar një proces të rregullt gjyqësor. Është e kundërta, ne
17 mendojmë se hetimet dhe rezultatet e këtyre hetime janë në interes
18 të drejtësisë. Këto parashikohen edhe mbështeten madje edhe në
19 kuadrin e Rregullores për Provat dhe Procedurën në atë mënyrë që
20 arrin një drejtpeshim që i afrohet tek e fundit një gjykimi sa më
21 të drejtë.

22 Faleminderit, i nderuar z. Gjykatës.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Tieger.

24 Unë nuk do ta caktoj që sot datën për fillimin e gjykimit,
25 por e kam dëgjuar këtë shkëmbim të rëndësishëm të pikëpamjeve të

1 palëve dhe patjetër që kjo do të trajtohet në Konferencën e ardhme
2 për Ecurinë e Çështjes.

3 Nëse nuk keni gjë tjetër për të thënë për këtë pikë të rendit
4 të ditës, do të kalojmë në tjetrën. Kjo pikë e rendit të ditës ka
5 të bëjë me hetimet e Mbrojtjes.

6 E di shumë mirë se është shumë herët në këtë moment që
7 Mbrojtja të jetë në gjendje të na japë një pamje të qartë të
8 afateve të tyre, por gjithsesi do të doja që të dija nëse e di
9 Mbrojtja këtë gjë. Së pari, në bazë të çmuarjeve të Prokurorisë
10 dhe në bazë të nxjerrjes në vazhdimësi të materialeve, e
11 parashikuar që të vazhdojë deri në korrik të vitit 2021, Mbrojtja
12 mund të japë më shumë informacion sa i takon faktit se ku është me
13 këto hetime. Po kështu do të doja të dija nëse Mbrojtja mund të
14 japë ndonjë informacion lidhur me synimet që ka për të bërë
15 kërkesa për mundësi unike hetimore, në përputhje me rregullën 99,
16 pika (1)//siç u përkthye//; dhe nëse Mbrojtja mund të japë ndonjë
17 informacion nëse do të japë njoftim alibie apo arsye për
18 përjashtim nga përgjegjësia ligjore.

19 Z. Hooper, në fillim ju.

20 Z. HOOPER: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Faleminderit z.
21 Gjykatës. Më bëhet shumë qejfi që dëgjova që ju përdorët pikërisht
22 këtë fjalën 'premature', pra, para kohe, sepse kështu është. Nuk
23 është momenti i duhur pra. Ne nuk kemi filluar që të mendojmë sa i
24 takon nisjes së hetimeve apo për të trajtuar këtë çështje.
25 Shpresoj që z. Gjykatës t'i respektojë arsyet për këtë, sepse

1 është tepër herët. Ne sapo kemi marrë materialet e para të
2 vendosura në dispozicion lidhur me materialet mbështetëse. Jemi
3 ende duke i shkarkuar. Për të mos folur pastaj që nuk kemi filluar
4 akoma me ekzaminimin e këtij materiali, apo që ende nuk kemi
5 filluar që të krijojmë një pikëpamje sa i takon bazës së këtij
6 materiali.

7 Sa i takon çështjes, të cilën në mënyrë elokumente z. Emmerson
8 trajtoi disa minuta më përpara, dua të them se kur z. Gjykatës na
9 drejtohet siç -- pra, për të bërë të ditur në emër të Mbrojtjes së
10 z. Thaçi sa i takon fillimeve, nëse mund ta them kështu, a do të
11 ishte një datë realiste për gjykimin vera e vitit 2022. Kjo nuk
12 është se ne e thamë për të kundërpeshuar parashtrimin qesharak do
13 të thosha të Prokurorisë, që kjo mund të bëhet për gjashtë muaj.

14 Në fakt, afati 18-mujor është thjesht minimumi që ne
15 parashikojmë për të filluar që të shikojmë nëse do të kemi ekipin
16 dhe aspektet e nevojshme për të bërë hetimet në terren për t'u
17 përgatitur për procesin gjyqësor, i cili pastaj, ky mund të
18 fillonte në verën e vitin 2022 nëse gjithçka do të ishte kështu.
19 Unë nga ana ime do të thosha, ose më saktë do t'i bëja jehonë
20 atyre që tha z. Emmerson sot.

21 Tek dëgjoj z. Tieger, prej këtu ku jam në Londër, më duhet që
22 ta pickoja veten për të kuptuar a isha në ëndërr apo jo. A i po i
23 thoshte me të vërtetë apo jo? Vërtetë po thotë se mund të bëhet
24 kështu ky gjyq? Dhe në të njëjtën mënyrë, nëse duam të flasim për
25 një proces të rregullt gjyqësor, po mendoj që kjo është e

1 pakonceptueshme. Sigurisht unë e mbaj mendjen e hapur kur i
2 drejtohem këtij institucioni, por duhet që të them se këto fjalë
3 të Prokurorisë janë zhgënjyese për mendimin tim.

4 Z. Gjykatës, ne nuk kemi filluar që të krijojmë ekipin
5 hetimor. Do të kërkojë kohën e vetë. Do të duhen të paktën 18
6 muaj, në mos më shumë, që të fillojmë të hetojmë këtë çështje. Ky
7 është realiteti. Z. Gjykatës e ka thënë se -- e ka shprehur sot që
8 nuk ka ndërmend që ka caktojë sot datën e fillimit të gjyqit. Por
9 po kështu ju keni thënë se kjo do të jetë temë diskutimi në
10 Konferencën e ardhshme për Ecurinë e Çështjes. Shpresoj dhe kam
11 besim që parashtrimet tona nuk do të bien në vesh të shurdhër, por
12 dua të them se kjo çështje do të kërkojë edhe shumë muaj të tjerë
13 që të zgjidhet. Faleminderit.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Hooper.

15 Z. Emmerson, fjala për ju.

16 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Edhe ne kemi
17 marrë disa hapa paraprakë sa i takon procesit të krijimit të një
18 mekanizmi hetimor. E vetmja gjë që kemi tani -- i vetmi dokument
19 që kemi deri tani që është i kuptueshëm për ekipin hetimor për të
20 filluar krijimin e një strategjie është pikërisht versioni më i
21 fundit, më pak i redaktuar i aktakuzës që na është vendosur në
22 dispozicion, por gjithsesi kjo mbase mund të na japë një ide për
23 numrin e incidenteve dhe një ide për gjeografinë, edhe sigurisht
24 edhe për emrat e disa prej personave të identifikueshëm.

25 Në bazë të këtij versioni më pak të redaktuar të aktakuzës,

1 del mjaft e qartë, siç e thashë edhe pak më përpara, se Mbrojtja
2 do të duhet që të kryejë një hetim mjaft të gjerësishëm për
3 secilin prej incidenteve të përmendura aty sa i takon akuzave për
4 keqtrajtim apo për vrasje.

5 Nëse mund ta them, në krahasim me çështje të tjera gjyqësore,
6 kjo është mjaft e pazakontë. Sigurisht, të paktën flas për ato
7 çështje të cilat unë njoh nga Gjykata Penale Ndërkombëtare apo nga
8 TPNJ-ja. Janë ngritur dyshime kundër të akuzuarve që përpiqet t'i
9 lidhë ata me një numër të madh krimesh ku ata nuk kanë qenë të
10 përzierë vetë drejtpërdrejt. Pra, kjo do të thotë se bëhet fjalë
11 për një numër shumë të madh incidentesh të veçanta, të cilat, me
12 aq sa kuptojmë ne, pretendojnë se ka një lidhje me një numër -- me
13 një grup, një guerilje që e quan vetveten -- që e quante vetveten
14 në atë rast Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

15 Të cilat pra, secili prej këtyre hetimeve kërkon kohën e vetë
16 dhe kërkon një këqyrje kritike përpara se të krijojmë një
17 pikëpamje sa i takon rrjedhøjave që vijnë prej tyre.

18 E them këtë, dhe dua që të jem i qartë që tani, sepse ka të
19 drejtë z. Tieger kur thotë se nuk mund ta krahasojmë këtë me
20 proceset e tjera gjyqësore të tribunalëve të tjerë, por unë do të
21 thosha, pikërisht ndodh kështu sepse kjo lëndë, kjo çështje kërkon
22 një hetim shumë më të hollësishëm në krahasim me ato të tjerat në
23 mënyrë që të shmangim edhe dublikimin e punës edhe të evitojmë
24 vonesat.

25 Por, unë do të thosha gjithsesi se kemi identifikuar një

1 ekspert me përvojë ndërkombëtare që të shërbejë si mbikëqyrës,
2 pra, për hetimin nga ana e Mbrojtjes për z. Veseli. Kemi
3 identifikuar një hetues me përvojë në Kosovë që është pjesë e
4 ekipit të Mbrojtjes.

5 Ne besojmë se do të rekrutojmë deri në gjashtë hetues në
6 terren. Në rastin e Haradinajt ne kemi përdorur një ekip të plotë
7 nga policia metropolitane e Londrës, pra, punonjës policie të
8 Londrës. Në këtë rast ne propozojmë një ekspert ndërkombëtar që të
9 mbikëqyrë një ekip juristësh të kualifikuar. Pra, kjo është pak a
10 shumë fusha e veprimit.

11 Sigurisht, nevojitet mundësia për të analizuar informacionet
12 që na vihen në dispozicion nga kjo mori e madhe dokumentesh që na
13 vendos në dispozicion Prokuroria, për të parë se cili është fushë
14 objekti. Objekti kërkon një përshkrim për të vendosur prioritetet,
15 pas të cilës pastaj mund të vendosim sesi të kryejmë intervistat e
16 ndryshme apo hetimet e tjera.

17 Nëse z. Tieger dhe ekipi i tij mendojnë se ne duhet ta
18 fillojmë këtë gjyq pa kryer hetimet tona të paktën -- që të jenë
19 të paktën aq të hollësishme sa të Prokurorisë, mendoj se ata e
20 kanë gabim atëherë. Mendoj se edhe ekipet e tjera të Mbrojtjes në
21 këtë rast do të donin që të bënë këto lloj hetimesh, se
22 përndryshe askush nuk do që të bëjë një gjykim që është thjesht
23 farsë.

24 Pra, mbasi të na -- mbasi të bëhet e ditur siç duhet çështja
25 pra, argumentet që paraqet Prokuroria, atëherë ne do të jemi në

1 gjendje që të përcaktojmë edhe objektin dhe skemën për hetimet
2 tona të Mbrojtjes. Ne dëshirojmë të mendojmë që mbasi të ketë
3 përfunduar pushimi gjyqësor tani do të kemi një tërësi materiale
4 nga Prokuroria me të cilat të fillojmë t'i studiojmë, t'i
5 analizojmë, të kuptojmë se çfarë drejtimi ndjekin.

6 Këtu do të thosha gjithashtu, ashtu siç e theksova edhe më
7 përpara, që kemi dy faza hetimesh. Faza e parë, ndërkohë që hetimi
8 i Prokurorisë nuk bëhet objekt i asnjë shqyrtimi gjyqësor dhe që
9 vazhdon deri në qershor, sipas afatit që ka përcaktuar z. Tieger,
10 ndërkohë që në qershor dhe në korrik kur vjen afati përcaktimor,
11 Prokuroria do të duhet që të kërkojë autorizim gjyqësor për të
12 futur prova të tjera shtesë në dosjen e tyre paraprake.

13 Ky është momenti kur Mbrojtja mund të thotë: Në rregull pra,
14 tani e dimë se cilat janë argumentet dhe provat e Prokurorisë dhe
15 mund të fillojmë edhe ne në varësi të shtyrjes gjyqësore të
16 shikojmë se cilat janë mundësitë tona. Z. Gjykatës, unë mendoj se
17 12 muaj është një minimum minimal do të thosha unë. Nuk besoj se
18 mund të fillojë gjyqi në korrik të vitit 2022. Unë mendoj që me
19 shumë gjasë do të fillojë nga fundi i vitit 2022 apo nga fillimi i
20 vitit 2023, po të kemi parasysh dy gjëra.

21 E para është afati i Prokurorisë, i cili do të vazhdojë të
22 shtyhet goftë edhe për shkak të fushatës së vaksinimit kundër
23 sëmundjes COVID, e cila do të vazhdojë gjatë vitit të ardhshëm.
24 Kjo do të ndikojë në hetimet të cilat do të bëhen nga afër me
25 personat.

1 Ndërkohë që faktori tjetër, siç e dini ju, janë pikërisht
2 kërkesat nga ana e Mbrojtjes lidhur me juridiksionin. Pra,
3 kundërshtimi, zbrapsja që do t'i bëjë Mbrojtja juridiksionit,
4 kompetencës së Gjykatës.

5 Pra, afati minimal që kemi -- për të cilin flasim, kemi
6 gjashtë muaj që ka Prokuroria, pastaj dhe janë 12 muaj pas këtij
7 afati kur mund të dorëzohet dosja paraprake gjyqësore. Mendoj se
8 bëhet 18 muaj, siç e kemi sugjeruar edhe ne që në fillim.

9 Por unë mbështes plotësisht qëndrimin e z. Hooper, siç e tha
10 ai, pra, që ky është minimumi bazë. Por ekziston edhe mundësia për
11 të shkuar përtej këtij afati. Sepse së pari, është mundësia për
12 apelimet e ndërmjetme, por së dyti, është dhe problemi i COVID-it.
13 Por edhe ajo që thotë vetë z. Tieger.

14 Vetë z. Tieger ju thotë që është -- të jetë jetike është në
15 interesin e drejtësisë që Prokuroria të jetë në gjendje të vijojë
16 hetimet e veta edhe përtej kësaj datës përcaktimore, po kjo vlen
17 edhe për Mbrojtjen.

18 Kështu që 18 muaj është minimumi bazë fare, i padiskutueshëm,
19 por kjo është një datë optimiste. Ne do ta informojmë Dhomën
20 Gjykimore plotësisht me -- Dhomën e Procedurës Paraprake do ta
21 mbajmë të informuar dhe do ta bëjmë këtë në mënyrë profesionale.

22 Z. YOUNG: [Përkthim] Ne e mbështesim plotësisht atë që tha z.
23 Emmerson. Faleminderit.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Young.

25 Znj. Alagendra.

1 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] I nderuar,
2 z. Gjykatës, ne gjithashtu mbështesim parashtimet e z. Hooper dhe
3 z. Emmerson. Është shumë realiste që 18 muaj do të ishin minimumi
4 i nevojshëm për t'u përgatitur për hetimet tona si Mbrojtje. Kaq
5 kisha z. Gjykatës.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit shumë znj.
7 Alagenda.

8 Z. Tieger, doni të përgjigjeni?

9 Z. TIEGER: [Përkthim] Jo, i nderuar z. Gjykatës,
10 faleminderit.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Tieger.

12 Sigurisht nuk do të flasim -- nuk do të marrim vendim sot sa
13 i takon kohëzgjatjes së hetimeve, por i mbajta shënim të gjitha
14 ata që u thanë. Siç e kam thënë më përpara, patjetër që ne do të
15 diskutojmë për këtë çështje edhe në Konferencat e ardhshme të
16 Ecurisë së Çështjes.

17 Meqë ra fjala këtu, dëshiroj që të pyes palët se si mendojnë
18 ato, cila është një datë e përshtatshme për Konferencën e ardhshme
19 mbi Ecurinë e Çështjes. Dhe gjithashtu nëse avokatët e të
20 akuzuarve duan të marrin pjesë përmes videokonferencës, duhet që
21 të paraqesin njoftim me shkrim 24 orë paraprakisht, në mënyrë që
22 Zyra e Administratës të marrë masat e duhura. Kjo vlen edhe për
23 pëlqimin me shkrim nga të akuzuarit.

24 Z. Prokuror.

25 Z. TIEGER: [Përkthim] Faleminderit. Ne mendojmë se Konferenca

1 e ardhshme për Ecurinë e Çështjes duhet që të zhvillohet të janar,
2 që përputhet edhe me pikëpamjen tonë të përgjithshme sa i takon
3 nevojës për Konferenca të shpeshta dhe të rregullta për Ecurinë e
4 Çështjes, në të cilat mund të konstatojmë dhe të orientojmë më tej
5 progresin e kësaj çështjeje dhe të zbatojmë hapat e nevojshme nga
6 të gjitha palët për të shkuar drejt gjyqit.

7 Sigurisht, kjo vlen për të gjitha palët, por unë do të
8 nënvizoj se kjo -- se ka rrethana ku kjo është më e rëndësishme.
9 Bëhet fjalë për ato rrethana apo hapa kur mund të merren përgjigje
10 për disa pyetje se kur mund të bëhen disa hapa të caktuar, kur
11 këto hapa shtyhen në kohë, qoftë edhe në bazë të parashtrimeve që
12 bëjnë palët sa i takon fillimit të gjyqit.

13 Në këto rrethana, ne mendojmë se Gjykata nuk duhet që të
14 lejojë të ketë periudha të gjata kohore midis konferencave të
15 tilla, në mënyrë që të monitorojë progresin dhe të vendosë afate
16 për të mos lejuar që çmuarjet që bëjmë për fillimin e gjyqit në të
17 ardhmen e largët të kthehen -- të bëhen thjesht profeci të kota.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Hooper, urdhëroni.

19 Z. HOOPER: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Deri më tani kemi
20 pasur Konferenca për Ecurinë e Çështjes të paktën një herë në
21 muaj, dhe propozoj që të mbajmë të ardhshmen nga fundi i janarit.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Hooper.

23 Z. Emmerson.

24 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Unë dua t'u
25 përgjigjem vështirimeve që paraqiti z. Tieger. Menaxhimi i

1 përgatitjeve për gjykim është një proces i rëndësishëm në mënyrë
2 që të bëj një vlerësim të drejtë. Dhe duke marrë parasysh
3 parashtrimin e z. Tieger se Mbrojtja po përpiqet që të stërgjatë
4 procesin e përgatitjeve të veta, unë mendoj që ky parashtrim është
5 i pavend.

6 Dhe ne pajtohemi që mbajtja e Konferencës për Ecurinë e
7 Çështjes një herë në muaj është në parim ashtu siç duhet të bëhet,
8 në mënyrë që të përditësohen dhe të shkëmbehen informacione të
9 mëtejshme.

10 Afati apo orari për Konferencën e ardhshme do të sugjeroja që
11 të ishte 14 janari i vitit të ardhshëm. Sikurse theksova në
12 parashtrimet me shkrim për Konferencën e sotme, në emër të z.
13 Veseli kemi bërë një kërkesë për lirim të ndërkohshëm dhe këtë
14 parashtrim e kemi bërë brenda afatit kohor. Ne do të kërkonim prej
15 jush që të caktoni afatet për dorëzimin e përgjigjes së
16 Prokurorisë deri më 31 dhjetor, dhe për dorëzimin e
17 kundërpërgjigjes së Mbrojtjes deri më datën 11 janar, dhe të
18 caktoni datën për Konferencën e ardhshme të Ecurisë së Çështjes më
19 14 janar, ku do të kishim diskutuar edhe gojarisht parashtrimet
20 tona për lirim të përkohshëm.

21 GJYKATËSI GUILLLOU: [Përkthim] Ju faleminderit z. Emmerson.
22 Mirëpres parashtrimet tua me shkrim.

23 Unë siç thashë në fillim të seancën, në vendimin tim të
24 mbrëmshëm kam trajtuar këto aspekte që ngritët ju, mirëpo siç
25 thashë, mirëpres parashtrimet tua të mëtejshme.

1 Z. Young.

2 Z. YOUNG: [Përkthim] Edhe unë propozoj që Konferenca të
3 mbahet mbas një muaji.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Znj. Alagendra.

5 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Edhe unë
6 pajtohem me këtë afat.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Do ta caktoj datën e
8 Konferencës për Ecurinë e Çështjes në kohën e duhur. Edhe unë ndaj
9 mendimin me ju që të paktën një herë në muaj të mbahen konferenca
10 të tilla në mënyrë që të vlerësohet progresi që po bëjnë palët, të
11 bashkërendohen shkëmbime. Unë mendoj që palët kanë nevojë për kohë
12 për të kryer hetimet e tyre dhe se kjo është në përfitim të një
13 gjykimi të drejtë, mirëpo dua që këto përgatitje të jenë sa më të
14 shpejta.

15 Dhe dua të siguroj që palët do të bëjnë përgatitjet e tyre në
16 mënyrë që të kryhet një gjykim i shpejtë.

17 Transkripti në kohë reale u ndërpre për një moment gjatë
18 kësaj seance, mirëpo kjo nuk do të thotë që nuk do të kemi
19 transkriptin e plotë në fund të kësaj seance.

20 E shikoj që Sekretarja e Gjykatës do të thotë diçka. Me sa
21 duket vetëm për mua nuk punon transkripti, për të tjerët punon. Si
22 duket ky problem duhet të zgjidhet vetëm me disa kompjuterë, por
23 siç thashë edhe më herët, kjo nuk do të thotë që nuk do të keni
24 transkriptin e plotë në fund të kësaj seance.

25 Do të kërkoja tani nga palët në qoftë se kanë edhe ndonjë

1 pikë tjetër për të ngritur në këtë moment. Do të filloj me
2 Prokurorin.

3 Z. TIEGER: [Përkthim] Jo, i nderuar Gjykatës, nuk kemi asgjë
4 për të ngritur.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Tieger.

6 Z. Hooper.

7 Z. HOOPER: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Po, tre pika.

8 [REDACTED]

9 [REDACTED]

10 [REDACTED]

11 [REDACTED]

12 [REDACTED]

13 [REDACTED]

14 [REDACTED]

15 [REDACTED]

16 [REDACTED]

17 [REDACTED]

18 [REDACTED]

19 [REDACTED]

20 [REDACTED]

21 E dyta. Pika e dytë ka të bëjë -- dhe unë mora vendimin tuaj,
22 i nderuar Gjykatës, të paktën e pashë dje vendimin tuaj në lidhje
23 me zgjatjen e afateve për parashtrimin e mocioneve paraprahe në
24 lidhje me juridiksionin apo kundërshtimin e formës së aktakuzës.

25 Do të ketë kundërshtime si në lidhje me juridiksionin ashtu

1 edhe me formatin e aktakuzës. Të paktën unë pres që të ketë
2 kundërshtime të tilla. Ne e çmojmë, i nderuar Gjykatës, shtyrjen e
3 këtij afati deri më 10 shkurt. Dua ta ndaj me ju atë që mu vu në
4 mendje -- vëmendje më parë nga kolegët e mi. Pozicioni apo
5 qëndrimi këtu ndoshta mund të jetë i ndikuar nga rregulla 97(2).

6 Në këtë kontekst, dhe duke e parë këtë në lidhje me urdhrin
7 tuaj për masa mbrojtëse që në fakt shtyn nxjerrjen e disa
8 materialeve apo zbardhjes së një informacioni, pra, ne nuk mund të
9 marrim një vendim përpara se të dalin vendime të ndryshme të
10 mëtejshme lidhur me materialin përkatës.

11 Rregulla 97(2) thotë për sa i përket të akuzuarit, ai mund të
12 parashtrojë mocione paraprahe me shkrim.

13 "Këto mocione duhet të jenë në formë të shkruar dhe duhet të
14 dorëzohen brenda një afati tridhjetë (30) ditësh pas dorëzimit të
15 të gjitha materialeve dhe deklaratave."

16 Në qoftë se kjo që thuhet në rregull është e saktë dhe në
17 qoftë se marrim parasysh faktin se Prokurori nuk do të nxjerrë
18 material deri më 15 janar, të paktën në lidhje me disa aspekte,
19 atëherë ne do të kishim kërkuar 30 ditë shtyrje të atij afati nga
20 ajo datë. Pra, kështu janë rrethanat edhe për këtë edhe e ngrita
21 këtë pikë.

22 I nderuar Gjykatës, ju lus që të reflektoni mbi këtë pikë dhe
23 që të nxirrni një vendim në qoftë se jemi dakord për këtë
24 interpretim që i kam bërë unë kësaj rregulle.

25 Pika e tretë dhe e fundit që kam për të ngritur, lidhet me sa

1 vijon: Kërkesat për lirim të ndërkohshëm. Dje, apo më mirë të them
2 sot në mëngjes, kam marrë përgjigjen e Prokurorisë në dokumentin
3 me numër F149. Lidhur me këtë, përgjigjja e Prokurorisë është
4 bukur e gjatë. Janë 21 faqe argumente të shoqëruara me 200 faqe
5 material mbështetës, të cilat ende unë nuk i kam.

6 Atë që kërkoj unë është që kundërpërgjigjja e Mbrojtjes në
7 kushte normale do të duhej të dorëzohej brenda pesë ditësh, mirëpo
8 unë do t'ju kërkoj që ta shtyni këtë afat. Pse? Sepse ky është një
9 aspekt mjaft i rëndësishëm. Kemi një parashtrim mjaft të gjatë, të
10 paktën nuk e kemi pritur të jetë kaq i gjatë nga Prokuroria lidhur
11 me këtë çështje. Dhe gjithashtu kjo lidhet me njëfarë shkalle të
12 ekzaminimit apo shqyrtimit, apo hetimit që duhet të bëjmë ne.

13 Në lidhje me vendimin tuaj, i nderuar Gjykatës, mbi kërkesat
14 tona për seancë dëgjimore në lidhje me parashtrimet për lirim të
15 ndërkohshëm, dua të them se në baraspeshim, ne në bazë të përvojës
16 që kemi, pritëm që ju do të keni mirëkuptim në këtë drejtim duke
17 marrë parasysh edhe realitetin e tribunalëve të tjerë
18 ndërkombëtarë.

19 Çështjet që ne do të dëshironim t'i ngrinim përpara Gjykatës
20 në seancë dëgjimore duhet të jenë të përmbledhura dhe tani duhet
21 të parashtrojmë ato argumente të mëparshme që kemi pasur. Nuk janë
22 argumente shtesë, por janë thjesht në mbështetje të pretendimeve
23 tona sepse duhet të bëhet lirimi i përkohshëm.

24 Duke marrë parasysh edhe kufizimet që shkakton pandemia e
25 COVID-it, Mbrojtja në këtë fazë po futet në një fazë të

1 aktivitetëve, ju siç e dini, jo vetëm që po marrim tani materialin
2 mbështetës nga Prokuroria dhe duhet të trajtojmë atë material, ne
3 gjithashtu jemi edhe -- po merremi edhe me ngritjen e ekipeve
4 tona, formimin e ekipeve tona të Mbrojtjes. Po flasim për mocione
5 paraprahe mjaft komplekse.

6 Dhe qëllimi im ishte që të vija në Hagë të hënën dhe të
7 martën që vjen në mënyrë që të zhvilloja diskutime të
8 drejtpërdrejta me z. Thaçi, por kjo nuk mund të ndodhë për shkak
9 të kufizimeve lidhur me COVID-in. Siç e dini, i nderuar Gjykatës,
10 ju mund të shkoni në një hotel në Hagë tani por aty nuk mund të
11 hani, dhe kjo na i kufizon mundësitë.

12 Të gjitha këto kufizime i kemi të qarta. E kemi të qartë se
13 janë bërë për shkak të shkallës së vdekshmërinë që shkakton
14 pandemia. Dhe masat që ka marrë Holanda dhe Anglia padyshim që
15 janë të kuptueshme. Pra, bëhet fjalë për më shumë faktorë të
16 ndërlikuar njëri me tjetrin.

17 Për sa i përket ekipit të z. Veseli, ata kanë marrë njëfarë
18 date të përafërt për parashtrimet e tyre në lidhje me lirim të
19 përkohshëm. Mendoj që përmendën 7 janarin. Kjo përfshin edhe
20 periudhën e Krishtlindjeve dhe disa festa të tjera.

21 Unë do të kërkoj nga ju, i nderuar Gjykatës, që ta shtyni
22 afatin, ta zgjatni këtë afat në mënyrë që të mund të përgjigjemi
23 në mënyrë të informuar.

24 Kaq kisha lidhur me këto parashtrime. Ju faleminderit, i
25 nderuar Gjykatës.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit z. Hooper.

2 A ju kam kuptuar drejt? Pra, ju kërkoni që t'ju jepet një
3 afat i ngjashëm me atë që është parashikuar për kërkesën e z.
4 Veseli, apo jo?

5 Z. HOOPER: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Po. Pikërisht
6 ashtu. Ne ndoshta kemi një mendim pak më të ndryshëm sepse kemi
7 bërë parashtrimin më herët. E di që ju, i nderuar Gjykatës, do ta
8 shqyrtoni rastin e secilit të akuzuar më vete në mënyrë të
9 vëmendshme.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit z. Hooper.

11 A do të thotë që ju hiqni dorë nga e drejta e z. Thaçi për
12 rishikimin e periudhës së mbajtjes në paraburgim çdo dy muaj?

13 Z. HOOPER: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Më falni, nuk e
14 kisha ndezur mikrofonin.

15 Dua që të flas me z. Thaçi, sepse nuk kam marrë udhëzimet
16 prej tij lidhur me këtë pikë, mirëpo duke u nisur nga bisedat që i
17 kam pasur me të më herët, mendoj që ai nuk do të krijojë kurrfarë
18 vështirësie. Ai na dëgjon për momentin.

19 Nuk është z. Thaçi ai që u tregua në ekran tani.

20 Dua t'ju them, i nderuar Gjykatës, se shkurt përgjigjja në
21 pyetjen tuaj është po, por sidoqoftë do të flas me z. Thaçi mbas
22 kësaj Konference për Ecurinë e Çështjes. Në qoftë se e kam pasur
23 gabim lidhur me qëndrimin e tij, atëherë do t'ju kthehem menjëherë
24 me një përgjigje.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Hooper. Edhe

1 unë do të sugjeroja kështu.

2 Z. Emerson, keni diçka për të shtuar?

3 Z. EMMERSON: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Jo.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Young.

5 Z. YOUNG: [Përkthim] Po, shkurtimisht. I nderuar z. Gjykatës,
6 nëse Prokuroria nuk është kundër pra, kërkesës për lirim të
7 përkohshëm që ka -- kërkesë e bërë nga z. Selimi, siç e kuptoj
8 pra, Prokuroria me sa kuptoj pra, ende nuk e ka bërë parashtimin
9 e vetë, siç e kam kuptuar edhe nga parashtimi i tyre i mëparshëm
10 sa i takon përgjigjes lidhur me këtë kërkesë. Unë do të kërkoja
11 pra, që -- do të isha mirënjohës nëse z. Gjykatës do t'i jepte
12 ekipit të z. Selimi të njëjtën shtyrje në kohë siç ia ka dhënë
13 edhe ekipit të z. Thaçi. Faleminderit.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Young, siç e pyeta dhe z.
15 Hooper, kjo do të kërkonte heqjen dorë nga e drejta e z. Selimi
16 për të pasur shqyrtim të -- rivlerësim të paraburgimit sipas
17 afatit dymujor. A mund të na jepni një përgjigje për këtë, nëse do
18 të ndodhë kjo në rastin tuaj?

19 Z. YOUNG: [Përkthim] Po, sa më shpejt do t'jua bëj të ditur
20 këtë gjë.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Young.

22 Znj. Alagendra.

23 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Edhe ne ka
24 shumë gjasë pra, që të kërkojmë kohë për përgjigje z. Gjykatës,
25 njësoj si ekipet e tjera sa i takon pra, kërkesës për lirim të

1 përkohshëm pasi të kemi dëgjuar nga Prokuroria.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit znj. Alagendra.

3 Me të njëjtat kushte besoj?

4 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Po, z.

5 Gjykatës.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit. I mbajta shënim

7 z. Hooper edhe dy çështjet e tjera.

8 Sa i takon të parës, desha që të them se depozitimi i
9 parashtrimeve që janë konfidenciale nuk do të diskutohen në seancë
10 publike. Pra, nuk do t'i trajtoj tani, do t'i trajtoj me shkrim
11 por i mbajta shënim. Sa i takon -- unë do t'i kërkoja nëpunësit të
12 sallës që ta redaktojnë pra, këtë përmendje pra, nga transkriptimi.

13 Dhe gjithashtu mbajta shënim edhe atë që kërkuat ju sa i
14 takon mocioneve të ardhshme paraprake, lidhur me afatet pra.

15 Nuk e di nëse ka gjëra të tjera? Znj. Lawson, e shoh që jeni
16 ngritur më këmbë.

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit z. Gjykatës. Sa i takon
18 çështjes së parë që është ngritur nga z. Thaçi, nuk do të them gjë
19 tjetër veçse që, siç e thatë ju, është ende në diskutim
20 ndërgjyqësor.

21 Sa i takon mocioneve paraprake, ne nuk shikojmë ndonjë bazë
22 sa i takon shtyrjes në lidhje me rregullën 97(2). Është shumë e
23 qartë që lloj i çështjeve që përpiqen të synojnë -- që përpiqen të
24 trajtojnë mocionet paraprake kanë të bëjnë pikërisht me këtë.
25 Materiali shumë i kufizuar që është vendosur në këtë vendim të

1 shtyrë nuk ka gjasa që të ketë ndikim në këtë gjë.

2 Sa i takon kërkesës për shtyrje të kohës sa i takon
3 përgjigjes lidhur me mocionet për lirim të përkohshëm, Prokuroria
4 është kundër këtyre kërkesave fuqimisht. Ne e kemi parashtruar
5 përgjigjen tonë sa i takon z. Thaçi pra, që e kemi dhënë këtë
6 përgjigje dje në kohën e duhur pra, brenda afatit standard me
7 numrin e fjalëve, pra, brenda dhe kufirit të numrit të fjalëve të
8 vëllimit të materialit. Ne të njëjtën gjë do të bëjmë sot për z.
9 Selimi dhe z. Krasniqi. Të gjitha palët pra, njoftohen për
10 rëndësinë e bërjes së parashtrimeve të plota duke pasur parasysh
11 edhe objektin e kufizuar të përgjigjeve të autorizuara lidhur me
12 këto kërkesa. Faleminderit.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit znj. Lawson.

14 Dikush do që të shkojë diçka. Z. Hooper.

15 Z. HOOPER: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Nëse mund të
16 them, pra, thjesht, se përgjigjja e Prokurorisë përfshin edhe
17 çështjet e reja që ngrihen dhe këto çështje kanë nevojë për hetim.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Hooper.

19 Nuk shoh ndonjë tjetër që të kërkojë fjalën.

20 Në rregull. Kjo do të thotë se këtu mbyllet seanca për sot.
21 Falënderoj palët dhe të akuzuarit për praninë e tyre. Falënderoj
22 përkthyesit, stenografët, teknikët dhe personelin e sigurisë për
23 asistencën e tyre.

24 Këtu mbyllet kjo seancë. Faleminderit.

25 --- Konferenca për Ecurinë e Çështjes përfundon në orën 12.33